



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 26 Prot.

Tiranë, më 10/07/2020

**V E N D I M**

**Nr. 7, datë 10/07/2020**

**MBI ANKESËN E Z. VLADIMIR KASEMI**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës” neni 6, pika 2.9 dhe neni 38, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve mori në shqyrtim ankesën e datës 09.07.2020 të paraqitur nga Z. Vladimir Kasemi, mbi regjistrimin si kandidatë për anëtar Senati Akademik të Z. Erald Piperi dhe Znj. Eralda Xhafka.

Pas shqyrtimit të ankesës, materialeve të paraqitura nga ankuesi si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët Eralda Xhafka dhe Erald Piperi, rezultoi se:

Sipas Vërtetimit nr. 6839 prot, datë 15.09.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, grada shkencore “Doktor” e fituar në Itali nga Z. Erald Piperi, është e barasvlefshme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë dhe është regjistruar me numër rendor 311 në regjistrin themeltar për gradën shkencore dhe titujt akademik të mbrojtur jashtë vendit, të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Sipas Vërtetimit nr. 7740/6 prot, datë 01.08.2016, grada shkencore “Doktor” e fituar në Itali nga Znj. Eralda Xhafka, është e barasvlefshme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë dhe është regjistruar me numër rendor 402 në regjistrin themeltar për gradën shkencore dhe titujt akademik të mbrojtur jashtë vendit, të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 6, pika 2.9 dhe nenin 38 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 6, datë 07.07.2020 të KIZ “Për regjistrimin e kandidatëve për rektor, si dhe anëtarë Senati Akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”.